

FUQITË E MËDHA DHE LIDHJA E PRIZRENIT

Zeqirja REXHEPI¹

^{*1}Corresponding author e-mail: zeqirja.rexhepi@unite.edu.mk

Hyrje

Lidhja Shqiptare e Prizrenit padyshim se është organizimi më i rëndësishëm politik dhe ushtarak i Rilindjes Kombëtare Shqiptare në shekullin XIX. Shfaqja e saj në skenën politike ndërkombëtare ndërlidhet me ngjarjet dramatike që janë zhvilluar në Ballkan si rrjedhojë e Krizës Lindore - Luftës Ruso-Turke (1877-1878). Epilogu i zhvillimit të Krizës Lindore ishte Traktati i Shën Stefanit, vendimet e të cilit dukshëm e rritën epërsinë e ndikimit të Ruisë në Ballkan në dëm të ndikimit të Austro-Hungarisë. Traktati i Shën Stefanit, përmes “Bullgarisë së Madhe”, në të vërtetë i hap rrugë hegjemonisë ruse, por edhe kontrollimit të Ngushticave Detare (Bosforit dhe Dardaneleve), me çka drejtpërdrejt rrezikohej Stambolli dhe Perandoria Osmane, sikurse dhe interesat e Fuqive të Mëdha perëndimore në Lindjen e Afërme, si: Britanisë së Madhe, Francës dhe Gjermanisë.

Krahas rrezikimit të interesave strategjike të Fuqive të Mëdha, Traktati i Shën Stefanit drejtpërdrejt i rrezikonte trojet shqiptare që ndodheshin nën administrimin osman.

Në Traktatin e Shën Stefanit, Rusia i shkëputte Perandorisë Osmane rreth 80 % të zotërimeve territoriale në Ballkan, por nuk mori gjë për vete, sepse pretendimet e saj territoriale synonte t’i realizojë përmes “Bullgarisë së Madhe”, e cila do të shërbente si satelite e Ruisë.¹

Në këto rrethana, synimet hegjemoniste ruse i vënë në pikëpyetje interesat e të gjitha Fuqive të Mëdha, këta të fundit nuk u pajtuan me Marrëveshjen e Shën Stefanit dhe për disa muaj organizuan Kongresin e Berlinit, në të cilin do të rishqyrtohen të gjitha çështjet e hapura. Duhet theksuar se, me këtë rast janë rishqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me interesat e Fuqive të Mëdha dhe të sferës së ndikimit të tyre (shteteve sllave), por jo edhe çështja shqiptare, e cila ishte në fazën e ndërkombëtarizimit të saj. Aq më tepër, në Kongresin e Berlinit, troje të banuara me shqiptarë etnikë bëhen pre e pazareve, duke iu shkëputur Perandorisë Osmane, për t’ju dhuruar shteteve fqinje ballkanike: Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë.

Nga kjo periudhë historike, pra nga Traktati i Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit fillon kalvari i shkëputjes sistematike të trojeve etnike shqiptare nga shtetet e përmendura ballkanike, me pëlqimin e Fuqive të Mëdha. Rilindasit shqiptarë të kohës e ndjenë rrezikun që u kërcënohej tokave shqiptare, prandaj janë përpjekur të organizojnë potencialet kombëtare shqiptare, pas sundimit pesëshekullor të Perandorisë Osmane. Me nismën e tyre, më 10 qershor 1878, tre ditë para mbajtjes së Kongresit të Berlinit, në Prizren u mblodh një Kuvend me rëndësi jetike për kombin shqiptar, në të cilin është formuar Lidhja Shqiptare, si një organizatë politike, e cila do ta drejtojë kauzën historike shqiptare.

¹ *Historia e popullit shqiptar II, Rilindja Kombëtare, vitet 30 të shekullit XIX – 1912*, Toena, Tiranë, 2002, 147.

Misioni i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte i trefishtë: të zgjojë ndërgjegjën e fjetur të shqiptarët; të imponohet si faktor politikë tek Fuqitë e Mëdha, duke ia marrë të drejtën Perandorisë Osmane t'i përfaqësojë shqiptarët dhe t'i mbrojë me armë trojet etnike, të cilat Kongresi i Berlinit ua kishte ndarë shteteve fqinje ballkanike.

Raportet midis Fuqive të Mëdha dhe Lidhja e Prizrenit

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, rajoni i Ballkanit që administrohej nga Perandoria Osmane vazhdon të mbetet arenë e krizave të rënda, me karakter ndërkombëtar, në të cilat janë implikuar Fuqitë më të mëdha të kohës.

Në vitet 50-ta të shekullit XIX, gjatë kohës së krizës së Krimesë (1853-1855), Franca dhe Anglia luajtën rolin kryesor, duke e rikthyer status-quo-në në Ballkan, parim të cilin e kishte rrezikuar Rusia me veprimet e veta ushtarake. Rreth njëzet vjet më pas, në një zonë tjetër të Ballkanit, përkatësisht në Bosnjë dhe Hercegovinë, shpërthen kriza e re (1875). Ndërkohë, harta politike e Evropës kishte ndryshuar, përpos fuqive ekzistuese, si: Franca, Anglia, Austria dhe Rusia, shfaqen edhe dy fuqi të reja evropiane: Gjermania dhe Italia.

Përderisa gjatë kohës së krizës së Krimesë nuk është ndjerë rreziku për trojet ku jetonin shqiptarët etnikë, kriza e dytë – kriza Lindore, e cila zhvillohet në kufijtë e Shqipërisë, i rrezikoi ndjeshëm trojet shqiptare.

Dalja në skenën evropiane të dy fuqive të mëdha, më 1871, dhe kundërthëniet midis tyre, gradualisht shkakton rirreshtimin e tyre, duke krijuar kështu aleancat politiko-ushtarake. Austro-Hungaria afrohet gjithnjë e më tepër me Gjermaninë, ndërsa Franca me Rusinë. Me këto rreshtime të reja janë formuar aleancat e mëdha ushtarake, të cilat do ta shpiejnë Evropën në Luftën e Parë Botërore.²

Zhvillimet e reja politike në Evropë e inkurajojnë edhe Rusinë Cariste ta përshpejtojë procesin e depërtimit në Ballkan, duke u përfshirë edhe drejtpërdrejt në luftimet kundër Perandorisë Osmane, siç ishte Lufta Ruso-Turke e vitit 1877.

Pikërisht, në kohën e ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), edhe pse në dukje Fuqitë e Mëdha kishin marrë vendime të përbashkëta, midis tyre “zienin” kundërthëniet të mëdha, të cilat përpiqeshin t'i zbutin përmes pazareve të ndryshme në kurriz të popujve të shtypur dhe të pambrojtur. Në kohën kur vendimet e Kongresit të Berlinit duhej të jetësohen lidhet Marrëveshja midis Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë (Marrëveshja Bismark-Andrashi).³ Edhe Franca, nga ana tjetër nuk qëndronte duarkryq. Ajo, gradualisht do t'i afrohet Rosisë, duke i “mbyllur sytë” para shtrirjes së ndikimit rus në Ballkan, në rajonin ku rrezikohen drejtpërdrejt tokat e shqiptarëve etnikë, e me këtë edhe kauza e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për mbrojtjen e trojeve etnike shqiptare.

Gjashtë fuqitë e mëdha: Gjermania, Britania e Madhe, Franca, Rusia, Austro-Hungaria dhe Italia, u mblodhën në Berlin, më 13 qershor, deri 13 korrik 1878, për të rishikuar vendimet e Traktatit të Shën Stefanit. Me këtë rast, Fuqitë e Mëdha nuk i morën parasysh fare kërkesat e delegacionit shqiptar të ngarkuar nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit.⁴ Kongresi i Berlinit nuk e njohu Shqipërinë dhe nuk e njohu as kombin shqiptar. Që situata të zhvillohet edhe më keq për shqiptarët, sipas nenit 23 të Traktatit të Berlinit, pamundësohej bashkimi i katër vilajeteve që ishte në kundërshtim me aspiratat autonomiste të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.⁵

² Misha Glenny, *Hitoria e Ballkanit 1804-1999*, Тоена, 2007, 135.

³ *Историја дипломатије* (свеска прва), Архив за правне и друштвене науке, Београд, 1949, 55.

⁴ *Historia e popullit shqiptar II, (vepër e përmendur)*, 162.

⁵ Po aty, 164.

Perandoria Osmane obligohej të hartonte *Rregullore Organike* për administrim autonom të Vilajeteve. Mbetja e trojeve shqiptare, të ndarë në katër vilajete ishte tërësisht në dëm të kauzës për të cilën angazhohej Lidhja e Prizrenit. Vendimi i Traktatit të Berlinit⁶, i dobësonte lidhjet ekonomike, politike dhe kulturore midis shqiptarëve dhe nga ana tjetër e favorizonte ndikimin e shteteve fqinje: të Serbisë në Vilajetin e Kosovës; të Bullgarisë në Vilajetin e Manastirit dhe të Greqisë në Vilajetin e Janinës.

Përkundër pikëpamjeve të Fuqive të Mëdha, të cilat mbi bazë të mosnjohjes së realitetit kombëtar shqiptar, duke e shpallur Lidhjen Shqiptare të Prizrenit si krijesë të qeverisë osmane, Lidhja Shqiptare synonte të mënjanohte pushtetin e kalbur osman me qëllimin themelor, mbrojtjen e trojeve etnike shqiptare. Këtë e vë re edhe vetë konsulli anglez në Shkodër, pas vrasjes së Mehmet Ali Pashës në Gjakovë, i cili thotë: “*Që në shenjat e para të përprjekjeve se po veprohet për të përcaktuar kufijtë e rinj shqiptaro-malazez, Lidhja Kombëtare ka të ngjarë të heq mënjanë autoritetet turke dhe ta marr mbrojtjen e vendit në dorë*”.⁷

Për sa i përket organizatës së Lidhjes së Prizrenit përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha kishin pikëpamje diametralisht të ndryshme. Mëdyshja tek Fuqitë e Mëdha ka qenë si rezultat i propagandës së fuqishme të Rusisë dhe të vendeve sllave ballkanike, të cilat e kanë prezantuar Lidhjen Shqiptare si një krijesë turke dhe jo si një realitet politik dhe ushtarak në skenën ballkanase dhe evropiane. Në këtë kontekst, ministri rus në Cetinë, z. Jonine, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit e paraqiste si “dordolec imagjinar” të vënë përpara nga Porta si shkas për t’iu shmangur detyrimeve të veta, ndërsa agjentët austriakë e prezantojnë Lidhjen si një realitet mjaft serioz.⁸

Nën ndikimin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, që tashmë jepte frytet e para, në ditën e fillimit të Kongresit të Berlinit, më 13 qershor 1878, Fuqive të Mëdha u dërgohet një *Memorandum*, në të cilin përpos tjerash u bëjnë me dije veçantitë kombëtare të shqiptarëve. Në këtë Memorandum mes tjerash thuhet: “*Përmes gjithë vështirësive shqiptarët kanë mundur të ruajnë pavarësinë e tyre, veçoritë, traditat dhe gjuhën kombëtare dhe qofshin katolikë, ortodoksë ose myslimanë, i urrejnë jo vetëm sunduesit e tyre turq po edhe gjithë të huajt tjerë*”.⁹

Nga kjo, mund të vërehet qartë se shqiptarët kishin filluar të ndërgjegjësohen kombëtarisht, duke u treguar Fuqive të Mëdha se Ballkani dhe Evropa duhet të llogaritin edhe për interesat e një kombi, tek i cili sapo ishte “trazuar” ndërgjegjja e fjetur.

Sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit, Fuqitë e Mëdha e njohin Malin i Zi si shtet të pavarur dhe i premtuan zgjerim territorial në krahinat e Tivarit, Podgoricës, Plavës e Gucisë... etj. Këtij premtimi evropian, shqiptarët iu kundërpërgjigjën, me nismën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u ndërmorën një sërë aktivitete për të kundërshtuar zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit, për sa i takon dorëzimit të trojeve shqiptare vendeve fqinje. Plava e Gucia, qytete shqiptare në Veri të Shqipërisë, të cilat sipas vendimit të Traktatit të Berlinit, duhej t’i dorëzohen Malit të Zi, deri kah fundi i vitit 1879. Mirëpo, Lidhja Shqiptare e Prizrenit e kundërshtoi fuqishëm vendimin e Fuqive të Mëdha.

⁶ Neni 23 i Traktatit të Berlinit.

⁷ Shkresa e Kirby Green, konsull anglez në Shkodër për gjendjen e tensionuar midis Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Qeverisë Osmane pas vrasjes së Mehmet Ali Pashës, nr. 70 Politike, Shkodër, 15 shtator 1878. PRO FO 78 Ç2841, Ramiz Abdyli, Libri II, 45.

⁸ Nga letra e Sir Henri Elliot, ambasador I BM. Në Vjenë për ministrin e punëve të jashtme të BM, markezin Salisbury, Vjenë 14 prill 1880, nr. 167 konfidenciale. Ramiz Abdyli, *Libri I*, 75.

⁹ Ramiz Abdyli, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze (1878-1881)*, *Libri II*. Përmbledhja e Memorandumit të 13 qershorit 1878 nga një zyrtar i lartë anglez kundër copëtimit të tokave shqiptare dhe nevojës së krijimit të shtetit autonom shqiptar. 40.

Veprimtaria e vendosur e Lidhjes Shqiptare, për t'i mbrojtur krahinat e përmendura shkaktuan divergjenca midis përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha. Kështu, Musun Pasha (Masurus Pasha), sipas ambasadorit anglez në Stamboll, Henry Layard, i paska thënë se, “*Porta do të bënte çmos për të arritur dorëzimin paqësor të territorit, se ata i kishin tërhequr trupat dhe autoritetet e tyre civile (dhjetor 1879), por nëse ata nuk ia arrijnë t'i bënë banorët t'u bindeshin paqësisht dispozitave të Traktatit, ai nuk mendonte se Traktati e kërkonte ose që Fuqitë mund të prisnin që qeveria osmane të hapte luftë kundër nënshitasve të saj të mëparshëm për t'i detyruar t'i nënshtroheshin asaj Fuqie nën autoritetin e së cilës duhej të kalonin.*”¹⁰

Ndërkohë që, zbatimi i vendimeve të Kongresit të Berlinit, për tokat që i ishin dhënë Malit të Zi, nuk realizohej për shkak të kundërshtimit nga Lidhja e Prizrenit, knjaz Nikolla i Malit të Zi nga fillimi i Nëntorit 1879 provoi të tërheq vëmendjen e Fuqive të Mëdha, përmes luftës së armatosur.

Në fillim të Janarit 1880 u përballën drejtpërdrejt ushtria malaziasë dhe ushtria shqiptare e Lidhjes së Prizrenit. Më 8 janar ushtria malaziasë pësoi disfatë dhe pjesët e mbetura të saj u tërhoqën brenda territorit të Malit të Zi.¹¹

Rezistenca e armatosur shqiptare kundër përpjekjeve ushtarake të Malit të Zi pati jehonë të jashtëzakonshme, me ç'rast fillon ndryshimi i opinionit publik evropian për shqiptarët. Nga kjo kohë, opinionit publik evropian fillon të interesohet për historinë e popullit shqiptar, ndërsa disa publicistë e kritikuan Kongresin e Berlinit që nuk i kishte përfillur të drejtat e një kombi trim dhe liridashës, siç ishte populli shqiptar.¹² Me fjalë tjera, përpjekjet politike dhe përpjekjet e armatosura të organizuara nga Lidhja e Prizrenit, e shpалosën çështjen kombëtare shqiptare në Ballkan, e cila kërkonte zgjidhje politike.

Kryekonsulli austro-hungarez në Shkodër, Shmuker, pas fitores së forcave ushtarake të Lidhjes Shqiptare kundër ushtrive malaziasë i raporton qeverisë së Vjenës, si vijon: “*Shqiptarët luftuan të shtyrë nga ideja kombëtare*”.¹³

Vendosmëria e shqiptarëve i detyroi Fuqitë e Mëdha ta rishqyrtojnë vendimin e mëparshëm, rreth Plavës dhe Gucisë dhe me propozimin e ambasadorit italian, kontit Corti, propozuan t'i jepeshin Malit të Zi, Hoti, Gruda dhe një pjesë e Kelmendit, me popullsi të besimit katolik. Sipas marrëveshjes, dorëzimi i këtyre viseve duhej të bëhej më 22 prill 1880.¹⁴

Se si janë zhvilluar raportet midis Fuqive të Mëdha, dhe pikëpamjet e tyre rreth Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në kohën kur zhvillohej veprimtaria e saj, dokumentet angleze hedhin dritë për rivalitetin midis dy fuqive pretendente për ndikim në Ballkan: Austro-Hungarisë dhe Italisë. Kështu, në njoftimin e konsullit anglez në Shkodër, Kirbi Green, që i dërgohet ministrit të punëve të jashtme të Britanisë së Madhe, Markezit Salisbury (21 mars 1880), pra në kohën kur zhvillohen ngjarjet rreth kufirit me Malin e Zi, vihen re kundërthëniet ose siç i quan konsulli anglez “xhelozit” e agjentëve konsullorë italianë që kishin ndaj agjentëve austriak në Shqipërinë e Veriut.¹⁵

¹⁰ Ramiz Abdyli, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881, Libri II, Prishtinë, 2004, f. 77. Nga shkreas e ambasadorit anglez në Stamboll, H. Layard dërguar Lordit Beaconsfield, Përfaqësues i delegacionit anglez në Kongresin e Berlinit, nr. 1495, 16 dhjetor 1879. PRO FO 78 Ç 2941.

¹¹ *Historia e popullit shqiptar*, 182.

¹² Po aty, 183.

¹³ *Historia e popullit shqiptar*, 183.

¹⁴ “Protokolli I Stambollit”, 19 prill 1880, sipas të cilit Sulltani I lëshon Malit të Zi në vend të krahinave të Plavës e Gucisë, Hotin dhe Grudën. *Historia e popullit shqiptar*, (vepër e përmendur), 185.

¹⁵ Ramiz Abdyli, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze*, Libri I, Instituti i historisë, Prishtinë, 2004, 43.

Dokumenti, në të vërtetë shpalos rivalitetet e dy fuqive fqinje, të cilat edhe pse kishin marrë obligime për vënien në jetë të vendimeve të Kongresit të Berlinit dhe “Protokollit të Stambollit”, më 18 prill 1880, përpiqen të krijojnë mundësi të reja ndikimi për periudhën vijuese.

Një paradoks tepër interesant mund të vihet re në dokumentet angleze të kohës. Në Raportet e përfaqësuesit diplomatik dërguar Ministrisë së Jashtme përmenden *shqiptarët* si popull, edhe përkundër faktit e ky popull (shqiptarët), nuk njihen në Kongresin e Berlinit. Në këtë kontekst, mund të kuptohet “hipokrizia” e konsullit anglez në Shkodër, z. Kirby Green, i cili në Raportin e 18 prillit 1880, që i dërgon ministrit të jashtëm britanik, Markezit Salisbury, në të cilën mes tjerash thotë: “*Jam përpjekur në të gjitha drejtimet për të gjetur qëllimet e vërteta të shqiptarëve të Veriut lidhur me ndryshimet e bëra tashti në kufirin shqiptaro-malazez dhe jam përpjekur të zbuloj nëse po i shtyn ata për kundërshtim ndonjë ndikim i jashtëm*”¹⁶

Sipas marrëveshjes (Protokollit të Stambollit), 24 orë para zbrazjes, komandantët e pikave të zëna nga ushtria osmane duhet të paralajmërojnë komandantin e ushtrisë së princit të Malit të Zi në Podgoricë për orën e saktë, në të cilën duhet të tërhiqen nga pikat e zëna. Mirëpo, në pasditen e 22 prillit 1880, në ditën kur ushtria turke duhej t’i lironte pozicionet në favor të ushtrisë malazieze, pozicionet i kapën shqiptarët që drejtoheshin nga Komiteti i Lidhjes në Shkodër. Në këto rrethana, Fuqitë e Mëdha kërkonin që Porta t’i ripushtojë pozicionet, të cilat i kishin zënë luftëtarët e Lidhjes Shqiptare dhe t’ia dorëzojë Malit të Zi

Edhe pse Fuqitë e Mëdha përpiqen të mbeten unike dhe të vendosura në vendimin e tyre, rreth përcaktimit të kufirit me Malin e Zi, megjithatë rezistenca e shqiptarëve për mosdorëzimin e pozicioneve të braktisura turke, i fut ato (Fuqitë e Mëdha) në dilema të reja rreth hapave që mund të merreshin. Një dilemë e këtillë shfaqet tek Austro-Hungaria, gjë që nuk mbetet pa u vërejtur nga ambasadori anglez në Vjenë, Sir Henri Elliot, i cili në letrën që i dërgon kontit Granville, ministër i Jashtëm i Britanisë së Madhe, shkruan: “*Lidhur me telegramin tuaj nr. 77 kam kuptuar nga gjuha e ministrit austriak të Punëve të Jashtme se si do të parapëlqente një politikë shtyerjeje ndaj shqiptarëve, më mirë sesa zbatimin e masave që ka të ngjarë të çojë në konflikt.*”¹⁷

Se midis Fuqive të Mëdha ekzistonin kundërthënie dhe dyshime të thella në veprime mund të vërehet edhe nga Raporti tjetër i konsullit anglez në Shkodër, Kirby Green që i dërgon ministrit të jashtëm të Britanisë së Madhe, Markezit Salisbury, (Shkodër 25 prill 1880), në të cilin pasi ia prezanton tërë ngjarjen rreth kufirit shqiptaro-malazez dhe aktivitetin e Lidhjes Shqiptare, rreth kësaj çështjeje. Me këtë, dyshohen veprimet e francezëve dhe italianëve (fundi i raportit)...“*marr guximin ta informoj Shkëlqesinë tuaj konfidencialisht, se konsulli italian dhe francez besohet se po e mbështetin fshehurazi lëvizjen e tanishme shqiptare, por përtej ekzistencës së kësaj përshtypjeje nuk kam ndonjë provë se po bëjnë kështu*”.¹⁸

Gjatë kohës së zhvillimit të ngjarjeve rreth kufirit me Malin e Zi, krerët e Lidhjes Shqiptare, përpos aktiviteteve të rezistencës së armatosur i kanë intensifikuar edhe veprimet diplomatike, duke iu drejtuar përfaqësuesve të huaj diplomatikë. Kështu, përfaqësues të Lidhjes Shqiptare, dy anëtarë të Komitetit Shqiptar (Shkodër), i drejtohen diplomatit anglez, z. Kirby Green, më 17 maj 1880, në të cilën thuhet: “*Kemi nderin t’ju dorëzojmë bashkëngjitur një telegram drejtues Shkëlqesisë së tij, Lordit Gladstone, me lutje që nëpërmjet jush ta çojë të sigurt në destinacion. Nënshkruar nga Ibrahim Efendi Dragusha dhe Andrea Shiroka.*”¹⁹

¹⁶ Po aty, 86.

¹⁷ Ramiz Abdyli, *Lidhja Shqiptare...*, 146. Vjenë 4 maj 1880.

¹⁸ Ramiz Abdyli, *Lidhja Shqiptare...*, 119. Z. Kirby Green, konsull anglez në Shkodër për markezit Salisbury, ministër i Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe. (nr. 78 Politike), Shkodër, 25 prill 1880.

¹⁹ Ramiz Abdyli, *Lidhja Shqiptare...*, 211, Shkodër 17 maj 1880.

Bashkëngjitje 2 në nr. 175

“Komiteti shqiptar për z. Gladstone.

Populli shqiptar, i përfaqësuar në këtë moment nga të nënshkruarit, ka nderin t’i dërgojë Shkëlqesisë suaj urimet më të mira me rastin e zgjedhjes suaj kryeministër i Lartmadhërisë së saj Britanike.

Ky popull njëkohësisht kërkon mbrojtjen e lartë të kombit të lavdishëm të Anglisë për çështjen e integritetit të tij territorial, të të drejtave të tij, për të cilat Shqipëria ka bërë përpjekje dhe ka dhënë jetën e saj”. Nënshkruar dhe vulosur, për Komitetin Shqiptar: Andrea Shiroka, Jovan Musani, Simon Simoni, Daut Efendiu, Selim Efendi Çorba, Sulejman Begu, Haxhi Agë Loha.²⁰

Rezistenca e vendosur e shqiptarëve për të mbrojtur tokat e tyre i vë në lëvizje diplomatët austro-hungarez, të cilët propozojnë alternativa të reja territoriale, të cilat duhej ti jepen Malit të Zi. Konti austriak Lipich në vend të Hotit e Grudës propozon kompensimin me zonat midis liqenit të Shkodrës dhe detit (më 1 qershor 1880). Anglia përmes konsullit anglez në Shkodër, Kyrbi Green, propozimi i paraqitet Princit të Malit të Zi. Këtë e mbështet edhe A-H. Princi malazez e ka pranuar propozimin e ri.

Divergjencat midis Fuqive të Mëdha janë vënë re edhe me rastin e dorëzimit të Ulqinit, i cili është dorëzuar nga Turqia më 26 nëntor 1880.

Përfundim

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX në Evropën Juglindore zhvillohet akti i fundit i dramës ballkanike. Kjo është koha kur në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare evropiane shfaqen fuqi të reja, si: Gjermania dhe Italia, me ç’rast “ç’rregullohen” marrëdhëniet tradicionale evropiane.

Perandoria Osmane, një shtet që e kishte humbur hapin historik me fuqitë tjera, ishte shndërruar në një boshllëk të paqëndrueshëm, i cili do të plotësohej me ndikimet e fuqive tjera.

Rusia, duke i shfrytëzuar shtetet e vogla sllave ballkanike, përpigj ta plotësojë këtë boshllëk në Ballkan, pra ta zëvendësojë Perandorinë Osmane. Ambicet e Ruisë shkaktuan të ashtuquajturën “krizë Lindore”, e cila zë fill me kryengritjen në Bosnjë dhe Hercegovinë për të vazhduar me luftëra, në të cilat hynë edhe vetë Rusia. E gjuhëzuar ushtarakisht, Perandoria Osmane i pranoi të gjitha kushtet e Ruisë, në Shën Stefan. Mirëpo, fuqitë tjera evropiane nuk e pranuan Marrëveshjen e Shën Stefanit, për shkak se drejtpërdrejt rrezikoheshin interesat e tyre.

Marrëveshjet politike, si ajo e Shën Stefanit, ashtu dhe e Berlinit, kësaj radhe i rrezikonin trojet shqiptare që ndodheshin nën administrimin osman.

Duke e ndjerë rrezikun e madh për tokat shqiptare, Rilindësit shqiptarë të kohës, pas një sundimi të gjatë osman, përpigjen të organizojnë potencialet e ndërgjegjshme kombëtare shqiptare, duke formuar një organizatë politike dhe ushtarake për t’u dalë zot tokave, të cilat rrezikoheshin nga fqinjët. Me nismën e tyre, më 10 qershor 1878, tre ditë para mbajtjes së Kongresit të Berlinit, në Prizren u mblodh një Kuvend me rëndësi jetike për kombin shqiptar, në të cilin është formuar Lidhja Shqiptare, si një organizatë politike, e cila do ta drejtojë kauzën historike shqiptare.

Misioni i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte i trefishtë: të zgjojë ndërgjegjen e fjetur te shqiptarët; të imponohet si faktor politik tek Fuqitë e Mëdha, duke ia marrë të drejtën Perandorisë Osmane t’i përfaqësojë shqiptarët dhe t’i mbrojë me armë trojet etnike, të cilat Kongresi i Berlinit ua kishte ndarë shteteve fqinje ballkanike.

²⁰ Po aty, 211-212.

Është për t'u theksuar se, në Kongresin e Berlinit, Fuqitë e Mëdha kanë sjellë vendime unanime, mirëpo kjo nuk do të thotë se ato ishin unike në shumë çështje. Përkundrazi, midis Fuqive të Mëdha ekzistonin mospajtme dhe kundërtënie, të cilat në rrethana tjera historike do të mund të shfrytëzohen për arritjen e qëllimeve kombëtare.

Në kohën e ngjarjeve vendimtare për të ardhmen e kombit shqiptar, Lidhja Shqiptare e Prizrenit duhej të përballet me:

- Qeverinë Osmane, e cila pas humbjes së rëndë që kishte pësuar në luftë me Rusinë, synonte ta shfrytëzojë energjinë kombëtare të Lidhjes Shqiptare për interesa të saj;

- Fqinjët grabitqarë, cilët pasi i kishin arritur objektivat e tyre në Kongresin e Berlinit (ishin njohur si shtet të pavarura), përpiqeshin ti vënë në jetë vendimet, rreth përfitimeve territoriale, të cilat nuk ishin asgjë tjetër, përpos toka shqiptare;

- Propagandën e fqinjëve dhe të Rusisë Cariste, për ta prezantuar Lidhjen Shqiptare si një organizatë e krijuar nga vetë qeveria osmane;

- Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në krye me Abdyl Frashërin, si një nga figurat më të spikatura kombëtare të idesë kombëtare, akoma nuk mund ti shfrytëzonte të gjitha kapacitetet kombëtare të shqiptarëve, për shkak të ndërjegjes së ulët tek shqiptarët, e cila ishte në pragun e zgjimit.

Burimet dhe literatura

- [1]. Traktatit të Berlinit, *Neni 23*.
- [2]. Abdyl, Ramiz, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze 1878-1881*, Libri II, Prishtinë, 2004, f. 45. Shkresa e Kirby Green, konsull anglez në Shkodër për gjendjen e tensionuar midis Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Qeverisë Osmane pas vrasjes së Mehmet Ali Pashës, nr. 70 Politike, Shkodër, 15 shtator 1878. PRO FO 78 Ç2841.
- [3]. Abdyl, Ramiz, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze 1878-1881*, Libri II, Prishtinë, 2004, f. 75. Nga letra e Sir Henri Elliot, ambasador i BM. Në Vjenë për ministrin e punëve të jashtme të BM, markezin Salisbury, Vjenë 14 prill 1880, nr. 167 konfidenciale.
- [4]. Ramiz, Abdyl, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze 1878-1881*, Libri II, Prishtinë, 2004, f. 40. Përmbledhja e Memorandumit të 13 qershorit 1878 nga një zyrtar i lartë anglez kundër copëtimit të tokave shqiptare dhe nevojës së krijimit të shtetit autonom shqiptar.
- [5]. Abdyl, Ramiz, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*, Libri II, Prishtinë, 2004, f. 77. Nga shkresa e ambasadorit anglez në Stamboll, H. Layard dërguar Lordit Beaconsfield, Përfaqësues i delegacionit anglez në Kongresin e Berlinit, nr. 1495, 16 dhjetor 1879. PRO FO 78 Ç 2941.
- [6]. Abdyl, Ramiz, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*, Libri II, Prishtinë, 2004, f. 185. "Protokolli i Stambollit", 19 prill 1880, sipas të cilit Sulltani I lëshon Malit të Zi në vend të krahinave të Plavës e Gucisë, Hotin dhe Grudën. *Historia e popullit shqiptar*, (vepër e përmendur).
- [7]. Abdyl, Ramiz, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze*, Libri I, Instituti i historisë, Prishtinë, 2004, f. 43.
- [8]. Ramiz Abdyl, Libri I, (vepër e përmendur) f. 119. Z. Kirby Green, konsull anglez në Shkodër për markezin Salisbury, ministër i Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe. (nr. 78 Politike), Shkodër, 25 prill 1880.
- [9]. *Историја дипломатије* (свеска прва), Архив за правне и друштвене науке, Београд, 1949.
- [10]. *Historia e popullit shqiptar II, Rilindja Kombëtare , vitet 30 të shekullit XIX – 1912*, Toena, Tiranë, 2002.
- [11]. Glenny, Misha, *Hitoria e Ballkanit 1804-1999*, Toena, 2007.